



Prishtinë: 27.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1216_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1994_10_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **29.11.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 27.12.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I.N. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPR – 125097** si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1994_10_19** i datës 31.10.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.11.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: shpenzimi dhe faturimi për periudhën 10/2016 është i saktë. Në ankesë theksohet se në raportin e qendrës së kalibrimit njehsori elektrik bllobat i ka të manipuluar, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, tabela e të dhënave është e gërvishur, numëruesi i manipulua, pra konsumatori ka manipuluar me njehsorin dhe për këtë nuk kanë marrë parasysh gjendjen në tarifën e ulët. Në ankesë theksohet se pasi që njehsori është manipuluar KEDS e ka ngarkuar konsumatorin në vlerë prej 6.76€ si faturë e rikthimit të humbjeve dhe ka marrë për bazë faturën e muajit 10/2016. Në ankesë theksohet se DMK gjatë marrjes së vendimit nuk ka marrë parasysh faturimin e rikthimit të humbjeve ku është përfshirë fatura e muajit 10/2016. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1994_10_19 të datës 31.10.2019 për konsumatorin I.N. me shifër DPR - 125097.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se shpenzimi dhe faturimi i konsumatorit për periudhën 10/2016 është i saktë, Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk është e saktë pasi që bazuar në të gjitha shkresat e lëndës shpenzimi i energjisë elektrik i konsumatorit për periudhën 10/2016 nuk paraqet shpenzim real mujor dhe kjo bazuar në procesverbalet e inspektimit, procesverbalin e kalibrimit dhe rrjedhën e energjisë elektrike aktive. Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizave të bëra shkresave të lëndës respektivisht transaksioneve të konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO nuk kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: **“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”.**

Se faturimi i periudhës për periudhën 10/2016 nuk paraqet shpenzim real mujor e dëshmon edhe fakti se gjatë analizës së bërë procesverbalit të inspektimit nr.2204970 të datës 07.11.2016 dhe rrjedhës së energjisë elektrike aktive është konstatuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin elektrik nr.7772631 e evidentuar në procesverbalin e lartëcekur prej TL=029071 kWh dhe TU=042789 kWh nuk përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën energjisë të muajit 10/2016 (data e leximit 01.11.2016), pasi që gjendja e shpenzimit të faturuar në atë periudhë ka qenë TL=28988 kWh dhe TU=44110 kWh, por që në muajin 11/2016 (data e leximit 01.12.2016) gjendja e shpenzimit të faturuar në atë periudhë ka qenë TL=29233 kWh dhe TU=42789 kWh.

Bordi i ZRRE për të parë se shpenzimi i energjisë elektrike i periudhës 10/2016 ka qenë real apo jo ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik dhe ka konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik nr.7772631, si dhe njehsorin e ri elektrik nr.67273236 për periudha të njëjta kohore, konstatohet se nuk ka ndryshim të shpenzimeve të energjisë elektrike mes këtyre njehsorëve, përjashtuar shpenzimin e muajit 10/2016. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.7772631, si dhe për periudhën 01/2015 deri në periudhën 09/2016 është 276.43 kWh/muaj, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.67273236 për periudhën 01/2017 deri në periudhën 09/2018 është 26 kWh/muaj, si dhe për periudhën 01/2018 deri në periudhën 12/2018 është 281.38 kWh/muaj. Gjithashtu është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike edhe përgjatë viteve me njehsorin nr.7772631 dhe me njehsorin nr.67273236 dhe është konstatuar se nuk ka ndryshim. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve: 2014 – 276.08 kWh/muaj; 2015 – 248.75 kWh/muaj; 2016 – 386.18 kWh/muaj; 2017 – 284.92 kWh/muaj; 2018 – 267.00 kWh/muaj. Pra nga kjo shihet qartë se mesatarja e shpenzimeve të energjisë elektrike sipas viteve mes njehsorit nr.7772631 dhe me njehsorin nr.67273236 nuk dallon përveç vitit 2016 ku vërehet qartë se mesataren e shpenzimit të këtij viti në krahasim me vitet tjera e rrit shpenzimi i energjisë elektrike i muajit 10/2016 i cili shpenzim ka qenë 1183.00 kWh. Bordi i ZRRE ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit të muajit 10/2016 me shpenzimet e energjisë elektrike para dhe pas kësaj periudhe, me të dy njehsorët elektrik nr.7772631 dhe nr.67273236, dhe ka vërejtur se ka dallim të madh mes shpenzimit të energjisë elektrike të muajit 10/2016 në krahasim me periudhat e njëjta para dhe pas kësaj periudhe. Ashtu siç u theksua edhe më lartë shpenzimi i energjisë elektrik i muajit 10/2016 ka qenë 1,183.00 kWh (me njehsorin nr.7772631), në periudhën 10/2014 ka qenë 202.00 kWh, në periudhën 10/2015 ka qenë 248.75 kWh



(me njehsorin nr.7772631), ndërsa në periudhën 10/2017 ka qenë 233.00 kWh, në periudhën 10/2018 ka qenë 291.00 kWh/muaj.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se në raportin e qendrës së kalibrimit njehsori elektrik bllobat i ka të manipuluar, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, tabela e të dhënave është e gërvishtur, numëruesi i manipuluar, pra konsumatori ka manipuluar me njehsorin dhe për këtë nuk kanë marrë parasysh gjendjen në tarifën e ulët, Bordi i ZRRE-së thekson se në rastet kur kemi të bëjmë me manipulim të njehsorit elektrik, atëherë KEDS është i obliguar të ndjek të gjitha dispozitat ligjore të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Megjithatë Bordi i ZRRE ju thekson se sipas nenit 4 paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë: *“Çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale dhe vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit për Energji Elektrike, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale Kundër Shërbimeve Komunale, ku përfshihet edhe vjedhja e energjisë termike (ngrohja qendrore) janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull”*. Andaj Bordi i ZRRE ju thekson se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe kompetente për zgjidhjen e këtyre ankesave janë vetëm gjykatat dhe për këtë nuk e ka shqyrtuar pjesën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, ku është vërejtur se shpenzimi i energjisë elektrike në disa periudha nuk është përputhur, në përgjigjen e KESCO nuk është dhënë asnjë sqarim me shkrim për këto mospërputhje, si dhe se shpenzimi i energjisë elektrike gjatë periudhës kontestuese (10/2016) ka ndryshim me periudhën para dhe pas periudhës kontestuese, si me atë njehsor elektrik ashtu edhe me njehsorin e ri elektrik, konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë është i saktë dhe drejtë, andaj konstaton se shpenzimi i energjisë elektrik i konsumatorit për periudhën 10/2016 nuk paraqet shpenzim real mujor dhe se KESCO duhet të shkarkoj konsumatorin nga kjo faturë e energjisë elektrike dhe për këtë periudhë të ngarkoj konsumatorin me shpenzimet e njëjta të energjisë elektrike për periudhën 10/2017 (TL=156 kWh dhe TU=77 kWh).

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit I.N. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.